

VENDIM
Nr. 154, datë 6.10.2016

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “XHENGO ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KASOLLET E SELCËS”, ME
FUQI
TË INSTALUAR 4000 kW**

Në mbështetje të neneve 16; nenit 37, pika 2, germa “a”; të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 21, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kasollet e Selcës”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kasollet e Selcës”, me fuqi 4000 KW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti